

Përmbledhje

Ekonomia e Eurozonës ka shënuar rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik përgjatë gjithë vitit 2019. Vetëm në TM4 2019, sipas të dhënave preliminare të Eurostatit, aktiviteti ekonomik shënoi rritje prej 1.0 përqind. Në linjë me aktivitetin e ngadalësuar ekonomik ka lëvizur edhe trendi i inflacionit (1.0 përqind). Ndërsa, në vendet e Ballkanit Perëndimor, rritja e aktivitetit ekonomik prej 4.3 përqind në TM3 2019 ishte e ngjashme me TM3 2018.

Sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale deri në shtator 2019 shënoi rritje mesatare vjetore prej 4.3 përqind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga përmirësimet e eksporteve neto. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM4 2019 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike gjatë këtij tremujori vlerësohet të ketë qenë më e dobët krahasuar me tremujorët paraprak të vitit 2019. Këto vlerësime mbështeten në zhvillimet jo aq të favorshme në sektorin e jashtëm (rënies së eksportit të mallrave dhe shërbimeve, rënies së IHD-ve, përsheptim të rritjes së importit, etj.) si dhe rënies së kredive të reja konsumuese dhe investuese.

Çmimet e konsumit deri në dhjetor 2019 janë rritur për 2.7 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë shënoi rritje prej vetëm 0.3 përqind apo 2.3 pikë përqindje më ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm.

Spektori fiskal në vitin 2019 u karakterizua me rritje të të hyrave buxhetore prej 7.5 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore prej 7.2 përqind. Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 168.4 milionë euro (162.7 milionë euro deficit në vitin 2018).

Si përqindje e BPV-së deficiti primar buxhetor ishte 2.3 përqind (2.4 përqind në vitin 2018). Borxhi publik në fund të vitit 2019 ka arritur në 1.2 miliardë euro, që është për 9.9 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.5 përqind nga 17.1 përqind sa ishte në vitin 2018.

Sistemi financiar gjatë TM4 2019 shënoi rritje për 243.2 milionë euro, rritje që i atribuohet kryesisht sektorit bankar dhe atij pensional. Spektori bankar rriti aktivitetin duke u mbështetur kryesisht nga niveli i lartë i depozitave, të cilat janë burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditor. Kontributet e arkëtuara dhe kthimit pozitiv nga investimet u reflektuan në performancë të mirë të sistemit pensional. Spektori i sigurimeve u karakterizua me performancë negative, përkundër rritjes së vlerës së primeve të shkruara, ndërsa sektori mikrofinanciar shënoi rritje më të ngadalësuar të aktivitetit, si rrjedhojë e ngadalësimit të kreditimit, veçanërisht për ekonomitë familjare.

Spektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 23.0 përqind. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ndërsa deficitit i mallrave shënoj rritje të ngadalësuar. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind ndërsa IHD-të shënuan rënie vjetore prej 2.1 përqind.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	1
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	4
Ekonomia e Kosovës -----	6
Sektori Real -----	6
Çmimet -----	6
Sektori Fiskal -----	7
Sektori Financiar -----	8
Sektori i Jashtëm -----	9

FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në Eurozonë-----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Inflacioni I përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	07
Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj-----	09
Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave-----	10
Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 8. Remitencat-----	11
Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve-----	11
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale-----	04
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit-----	05
Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin-----	07
Tabela 4. Treguesit e zgjedhur makroekonomik-----	13

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IÇI	Indeksi i Çmimit të Importit
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistikore të Bashkimit Evropian (Eurostat), në TM4 2019 ekonomia e Eurozonës shënoi rritje vjetore prej 1.0 përqind, që është një normë e rritjes lehtësisht më e ulët krahasuar me rritjen prej 1.2 përqind në TM4 2018 (figura 1).



Ky ngadalësim i aktivitetit ekonomik është ndikuar nga një varg faktorësh: dobësitë e vazhdueshme të tregtisë globale, ngadalësimi i rritjes ekonomike të Kinës, pasiguritë gjeopolitike, problemet lidhur me Brexit-in, etj. Dinamikat e tilla, që ndikuan drejtpërdrejtë në besueshmërinë e bizneseve, pritet të kenë pasoja në dinamikat e aktivitetit ekonomik edhe në periudhën afatmesme.

Në linjë me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik, edhe shkalla e inflacionit ishte më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Mesatarja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Eurozonë në TM4 2019 ishte 1.0 përqind (1.9 përqind në TM4 2018)

(figura 1). Si rezultat i nivelit të ulët të inflacionit, në shtator 2019, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së vendosi t'i mbajë të pandryshuara normën e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.50 përqind).

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 2.9 përqind ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.2 përqind. Në anën tjetër, depozitat në sistemin bankar janë rritur akoma më shumë dhe kanë shënuar normën e rritjes prej 5.6 përqind për ndërmarrjet dhe 5.5 përqind për ekonomitë familjare.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, aktiviteti ekonomik në TM3 2019¹ ka shënuar rritje vjetore të ngjashme me TM3 2018 (mesatarisht 4.3 përqind). Serbia, Kosova dhe Maqedonia e Veriut patën përsheptim të rritjes, ndërsa Shqipëria dhe Mali i Zi shënuan ngadalësim të rritjes krahasuar me TM3 2018 (tabela 1).

Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3
Serbia	5.0	5.0	4.2	3.5	2.7	2.9	4.8
Mali i Zi	4.8	5.2	5.3	4.9	3.0	3.2	4.7
Kosova	2.9	4.4	3.8	4.1	4.2	4.1	4.4
Shqipëria	4.3	4.3	4.7	3.3	2.6	2.5	3.8
Maqedonia e Veriut	0.9	3.0	3.0	3.7	4.1	3.1	3.6

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Në TM4 2019 norma mesatare e inflacionit prej 1.0 përqind ishte më e ulët krahasuar me normën e inflacionit prej 1.7 përqind në TM4 2018. Normat më të ulëta të inflacionit ishin evidente në të gjitha vendet

¹ Të dhënat për TM4 2019 nuk janë publikuar ende, ndërsa për Bosnje e Hercegovinën nuk janë publikuar që nga TM2 2018.

me përjashtim të Shqipërisë, ku norma e inflacionit rezultoi më e lartë (tabela 2).

Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4
Kosova	0.0	0.7	1.4	2.2	3.2	3.3	2.6	1.7
Mali i Zi	3.7	3.7	2.4	1.7	0.4	0.5	-0.1	1.1
Maqedonia e Veriut	1.5	1.5	1.6	1.2	1.2	1.2	0.6	0.0
Serbia	1.6	1.8	2.4	2.0	2.4	2.3	1.3	1.5
Shqipëria	1.6	1.9	2.1	1.5	2.0	1.5	1.5	1.6

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, pothuajse në të gjitha vendet kishte ngadalësim të rritjes së kreditimit, me përjashtim të Shqipërisë ku ishte shënuar rritje prej 7.1 përqind (-3.2 përqind në TM4 2018). Në TM4 2019, norma mesatare e rritjes së kredive (përjashtuar Shqipërinë) ishte 7.1 përqind (8.8 përqind në TM4 2018). Vendet të cilat shënuan normat më të ulëta të rritjes së kreditimit ishin Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina (4.5 përqind përkatësisht 5.9 përqind), ndërsa Kosova dhe Serbia shënuan normat më të larta krahasuar me vendet tjera (10.0 përqind përkatësisht 9.1 përqind).

Në anën tjetër, depozitat shënuan përshpejtim të rritjes. Në TM4 2019, norma mesatare e rritjes së depozitave ishte 8.2 përqind në nivel të rajonit (7.1 përqind në TM4 2018). Tek depozitat, sikurse tek kreditë, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Kosovë dhe Serbi (16.2 përqind përkatësisht 10.9 përqind), pasuar nga Maqedonia e Veriut me 9.5 përqind, Bosnja e Hercegovina me 8.4 përqind, etj.

Gjatë vitit 2019, euro është vlerësuar ndaj lirës turke për 10.4 përqind ndërsa është zhvlerësuar ndaj valutave tjera kryesore por edhe ndaj valutave të vendeve të rajonit. Ndaj dollarit amerikan është zhvlerësuar për 5.2 përqind, frankës zvicerane për 3.7 përqind, lekut shqiptar për 3.6 përqind, sterlinës britaneze 0.8 përqind dhe dinarit serb për 0.4 përqind.


Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Sipas të dhënave tremujore të ASK-së, aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje mesatare prej 4.3 përqind deri në shtator të vitit 2019 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018 kur ishte shënuar rritje prej 3.7 përqind. Rritjen më të lartë e shënuan aktivitetet financiare dhe të sigurimit (14.7 përqind), pasuar nga industria përpunuese (7.2 përqind), ndërtimtaria (6.8 përqindje) dhe tregtia (6.2 përqind).

Sipas qasjes së shpenzimeve, përshpejtim i rritjes së aktivitetit ekonomik ishte kryesisht rezultat i kontributit pozitiv të eksporteve neto prej 0.6 pikë përqindje (-4.7 pikë përqindje në periudhën e njëjtë të vitit 2018). Edhe kërkesa vendore kontribuoi pozitivisht me 1.8 pikë përqindje, ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit 2018, kontributi i kërkesës vendore ishte dukshëm më i lartë (4.2 pikë përqindje) (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK (2020) dhe llogaritjet e BQK -së

Deri në shtator 2019, kreditë e reja konsumuese shënuan rënie prej 3.3 përqind duke ndikuar kështu në ngadalësimin e rritjes së konsumit. Përveç rënies së

kredive konsumuese, edhe burimet tjera të financimit të konsumit si kompensimi i punëtorëve dhe shpenzimet për paga në sektorin publik u karakterizuan me ngadalësim të rritjes, ndërsa remitencat shënuan përshpejtim të rritjes. Përkundër rritjes së IHD-ve prej 15.1 përqind, rënia e investimeve publike prej 12.7 përqind ka ndikuar në rritjen më të ngadalësuar të investimeve të përgjithshme. Në anën tjetër, ngadalësimi i rritjes së kërkesës së brendshme ka ndikuar në ngadalësimin e rritjes së importit, ndërkohë që eksporti ka shënuar rritje të përshpejtuar. Kjo ka bërë që eksportet neto të shënojnë deficit më të ulët tregtarë prej rreth 2.4 përqind në terma real.


Meqenëse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në e TM4 2019 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, BQK vlerëson se rritja ekonomike gjatë këtij tremujori pritet të jetë më e dobët krahasuar me tremujorët paraprak të vitit 2019. Këto vlerësime kryesisht mbështeten në zhvillimet jo aq të favorshme në sektorin e jashtëm, i cili u karakterizua me rënie të eksportit dhe përshpejtim të rritjes së importit të mallrave. Përveç kësaj, edhe kreditë e reja konsumuese dhe investuese shënuan rënie.

Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit u rrit ndjeshëm që nga tremujori i fundit i vitit 2018 dhe ka vazhduar këtë trend të rritjes edhe në vitin 2019 (figura 3).

Deri në dhjetor 2019 norma mesatare e rritjes së çmimeve të konsumit ishte 2.7 përqind (1.1 përqind në vitin 2018).

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2020)

Kjo rritje e çmimeve ishte më e theksuar tek çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, të cilat kontribuan me 2.15 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm, pasuar nga çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit me 0.16 pikë përqindje si dhe çmimet e transportit me 0.13 pikë përqindje (tabela 3).

Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin

Përshkrimi	Peshat 2019	Norma e inflacionit	Kontributi
GJITHSEJ	100.0%	2.7	2.67
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	40.0%	5.4	2.15
Pijet alkoolike dhe duhani	5.6%	2.6	0.16
Veshmbathja	3.9%	0.2	0.01
Energjia	7.7%	0.1	0.01
Orenditë	7.9%	1.2	0.09
Shëndetësia	2.5%	0.7	0.02
Transporti	15.4%	0.8	0.13
Komunikimi	3.7%	0.2	0.01
Rekreacioni	4.4%	0.3	0.01
Arsimi	1.0%	-0.7	-0.01
Hoteleria	3.1%	1.4	0.04
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.9%	1.5	0.04

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Siç shihet në tabelë, shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan) dhe përjashtimi i

këtyre komponentëve bënë që inflacioni bazë të jetë më stabil (figura 3). Deri në dhjetor 2019, inflacioni bazë rezultoi të jetë 0.3 përqind, apo 2.3 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamikat e shportës së konsumatorit kosovarë përcaktohen kryesisht nga lëvizja e çmimeve të importit, të cilat deri në shtator 2019 shënuan rritje mesatare prej 3.2 përqind që është nivel paksa më i lartë se sa indeksi i çmimeve të konsumit. Përveç çmimeve të importit me rritje prej 1.2 përqind janë karakterizuar edhe çmimet e prodhimit por që kjo normë e rritjes ishte dukshëm më e ulët krahasuar me çmimet e importit.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore² në vitin 2019 arritën vlerën neto prej 1.89 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.5 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore³ arritën vlerën prej 2.06 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 7.2 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 168.4 milionë euro krahasuar me deficitin prej 162.7 milionë euro në vitin 2018. Si përqindje e BPV-së deficitin primar buxhetor ishte 2.3 përqind (2.4 përqind në vitin 2018).

Në kuadër të të hyrave tatimore, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 292.3 milionë euro (9.3 përqind rritje). Të hyrat tatimore indirekte arritën vlerën prej 1.42 miliardë euro apo 5.3 përqind më shumë krahasuar me vitin

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

2018. Të hyrat tatimore indirekte janë të lidhura kryesisht me importin e mallrave dhe përbëjnë rreth 74.9 përqind të gjithë të hyrave buxhetore. Me normë më të lartë të rritjes janë karakterizuar të hyrat jo-tatimore, të cilat arritën vlerën prej 226.6 milionë euro apo 17.5 përqind më shumë krahasuar me vitin 2018.

Rritja më e ngadalësuar e shpenzimeve buxhetore erdhi si pasojë e vonësve në aprovimin e Buxhetit për vitin 2019 nga ana e Kuvendit të Kosovës. Kategoria kryesore që kontribuojnë në rritjen e ngadalësuar të shpenzimeve buxhetore ishte ajo e shpenzimeve kapitale të cilat ishin në nivel të ngjashëm me vitin 2018 dhe arritën prej 530.8 milionë euro. Kategoritë tjera të shpenzimeve buxhetore shënuan rritje. Shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje prej 4.1 përqind dhe arritën vlerën prej 615.9 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje për 17.5 përqind dhe arritën vlerën prej 293.9 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 12.4 përqind dhe arritën vlerën prej 627.3 milionë euro.

Borxhi publik në vitin 2019 ka arritur në 1.2 miliardë euro që është për 9.9 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.5 përqind nga 17.1 përqind sa ishte në vitin 2018. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 17.0 përqind (i cili ka arritur në 791.9 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka rënë në 408.8 milionë euro që është për 1.8 përqind më i ulët krahasuar me vitin 2018. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithë borxhin publik është zvogëluar në 34.0 përqind nga

38.1 përqind sa ishte në 2018. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj dhe po ashtu e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit.

Sektori Financiar⁴

Asetet e sistemit financiar vazhduan të rriten edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2019, duke arritur vlerën 7.2 miliardë euro në dhjetor. Rritja e aktivitetit të sistemit financiar në TM4 2019 u mundësua kryesisht nga sektori bankar dhe ai pensional, që njëkohësisht kanë dhe peshën më të madhe në gjithë asetet e sistemit. Sektori bankar në TM4 2019 u zgjerua duke u mbështetur kryesisht nga niveli i lartë i depozitave të arkëtuara, të cilat janë burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditor. Gjatë TM4 2019, kreditimi për korporatat jofinanciare shënoi rritje më të theksuar krahasuar me kreditimin ndaj ekonomive familjare.

Edhe gjatë TM4 2019, performanca e sektorit bankar ishte e kënaqshme, duke gjeneruar fitim neto në vlerë prej 20.6 milionë euro. Mirëpo, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, sektori bankar ka shënuar rënie të profilit si rezultat i rënies së të hyrave (kryesisht nga jo-interesi), përderisa niveli i shpenzimeve të ndodhura ka mbetur pothuajse i njëjtë. Treguesit e cilësisë të portfolios kreditorë edhe gjatë TM4 2019 ishin në nivele të kënaqshme, me nivel të ulët të kredive joperformuese dhe rritje të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Për më shumë, edhe indikatorët e solvencës dhe likuiditetit janë mbi

⁴ Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM4 2019) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

nivelet minimale të rekomanduara me rregullore, që janë indikacion për një treg mirë të kapitalizuar dhe likuid.

Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha e rëndësisë në sistemin financiar, gjatë këtij tremujori vazhdoi të ketë rritje të aseteve, kryesisht si rezultat i kontributeve të arkëtuara dhe kthimit pozitiv nga investimet. Struktura e aseteve të sektorit pensional është e përbërë kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit (75.2 përqind) dhe nga mjetet e investuara brenda vendit, gjegjësisht në letra me vlerë dhe çertifikata të depozitit (23.3 përqind).

Sektori i sigurimeve edhe gjatë këtij tremujori u karakterizua me performancë negative, përkundër rritjes së vlerës së primeve të shkruara. Ngjashëm me primet e shkruara, edhe dëmet e paguara nga sektori shënuan rritje, e rrjedhimisht duke rezultuar në performancë negative financiare gjatë kësaj periudhe. Humbja më e lartë e realizuar krahas tremujorit paraprak ishte si pasojë e rritjes më të shpejtë të dëmeve (të paguara dhe të ndodhura) krahas rritjes më të ulët të primeve të shkruara.

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje më të ngadalësuar të aktivitetit në TM4 2019, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si rrjedhojë e rritjes më të ngadalësuar të kreditimit, veçanërisht për ekonominë familjare. Sektori realizoi nivel mjaftë të lartë të fitimeve neto në këtë tremujor, ndërsa niveli i kredive me probleme në fund të periudhës (dhjetor 2019) ka shënuar rritje krahasuar me periudhën


paraprake (dhjetor 2018), por mbeten në nivele mjaftë të ulëta dhe mirë të provizionuara.

Në tregun e letrave me vlerë, shuma e borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës arriti vlerën prej 40 milionë euro, që është dukshëm më e ulët se në TM4 2018. Kjo është rrjedhojë e kërkesës më të ulët të Qeverisë, pasi që ofertat prej akterëve kryesor në tregun e letrave me vlerë tejkaluan shumën e kërkuar.

Sektori i Jashtëm

Në vitin 2019, deficitin e llogarisë rrjedhëse ishte 391.8 milionë euro që është për 23.0 përqind më i ulët krahasuar me vitin 2018. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore por edhe ngadalësimit të rritjes së deficitit të mallrave (figura 4).

Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)


Deficiti në llogarinë e mallrave⁵ arriti vlerën prej 3.1 miliardë euro në vitin 2019, që paraqet një rritje vjetore prej 4.5 përqind (11.6 përqind rritje në vitin 2018). Kjo rritje më e ngadalësuar e deficitit të

⁵ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

mallrave ishte për shkak të rritjes së eksportit të mallrave dhe rritjes së ngadalësuar të importit, për dallim nga vitin 2018 kur ishte shënuar rënie e eksportit të mallrave dhe përshejtim i rritjes së importit.

Vlera e eksportit të mallrave arriti vlerën prej 383.5 milionë euro, apo shënoj rritje vjetore prej 4.4 përqind (-2.8 përqind në vitin 2018) (figura 5).


Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK (2020)

Rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar tek metalet bazë, produktet e plastikës dhe gomës si dhe makineritë dhe pajisjet elektrike. Në anën tjetër, rënie shënoj eksporti i produkteve minerale, eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, etj. (figura 6).


Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2020)

Vlera e importit të mallrave arriti në 3.5 miliardë euro, që është për 4.5 përqind më e lartë krahasuar me vitin paraprak, ndërkohë që në vitin 2018 ishte shënuar rritje prej 9.8 përqind. Në ngadalësimin e rritjes së importit të mallrave ka ndikuar kryesisht niveli më i ulët i importit të makinerive dhe pajisjeve mekanike si dhe importi i metaleve bazë ndërsa rritje më e lartë është shënuar tek importi i mjeteve të transportit, importi i kategorive ushqimore, importi i tekstilit dhe artikujve të tekstilit, etj. (figura 7).

Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2020)

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoj vlerën prej 932.3 milionë euro që paraqet rritje prej 8.9 përqind krahasuar me vitin 2018. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoj rritje vjetore prej 7.3 përqind, duke arritur në 1.68 miliardë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoj rritje prej 5.4 përqind dhe arriti në 743.9 milionë euro.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore shënoj vlerën prej 153.6 milionë euro, që paraqet një rritje prej 35.9 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore arriti në 1.36 miliardë euro që është për 8.1 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2018. Ky nivel më i lartë i bilancit të të ardhurave dytësore i atribuohet kryesisht nivelit

më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë shënuan vlerën prej 851.9 milionë euro apo 6.4 përqind më shumë krahasuar me vitin 2018 (figura 8).

Figura 8. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2020)

Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, prej nga dërgohen 40.6 përqind përkatësisht 20.2 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.0 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Llogaria financiare e bilancit të pagesave shënoj vlerën prej -185.3 milionë euro që është për 44.8 përqind më pak krahasuar me vitin 2018. Ky reduktim i bilancit negativ në llogarinë financiare ishte kryesisht rezultat i rritjes së investimeve jashtë Kosovës, qofshin investime portfolio apo investime direkte. Edhe detyrimet në kuadër të llogarisë financiare shënuan rritje (16.6 përqind) por që norma e rritjes ishte më e ulët krahasuar me asetet. Në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të në Kosovë arritën vlerën prej 266.5 milionë euro që janë për 2.1 përqind më pak krahasuar me vitin 2018. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 250.7 milionë euro dhe shënoj rënie prej 4.8

përqind, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 15.8 milionë euro (8.8 milionë euro në vitin 2018) (figura 9).

Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)

Rënia e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektori i ndërtimit dhe ai i shërbimeve tregtare, ndërsa sektori i patundshmërive, sektori i industrisë dhe ai i shërbimeve financiare shënuan rritje. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD (72.5 milionë euro), pasuar nga Zvicra me 61.9 milionë euro, SHBA-të me 21.0 milionë euro, Shqipëria me 18.3 milionë euro, etj.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2020): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 29, TM4 2019, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK (2020):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2019):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-prill-2019>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-icp-tm4-2018>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-importit-icimp-tm4-2018>
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/repertori-statistikor-mbi-ndermarrjet-ekonomike-ne-kosove-tm4-2018>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-mars-2019>

IMF (2020): World Economic Outlook:

<https://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2019/01/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	4,936.3	5,212.7
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.1%	2.7%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	2.9%	1.1%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,756.6	1,888.6
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,919.3	2,057.0
Bilanci primar (në milionë euro)	-162.7	-168.4
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	6,316.1	7,249.5
prej të cilave: Bankat	4,185.5	4,755.7
Kredi	2,755.5	3,031.9
Depozita	3,362.9	3,908.1
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.0%	6.4%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.5%	1.6%
Hendeku i normës së interesit	4.5%	4.8%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-519.9	-400.0
prej të cilave: remitencat e pranuar	800.5	851.9
Llogaria financiare	-335.5	-185.3
Investimet e huaj direkte në Kosovë	272.1	266.5
Investimet portfolio, net	-199.9	59.0
Investimet tjera, net	3.4	-138.7
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-126.5	-299.6
Asetet	5,005.8	5,185.2
Detyrimet	5,132.2	5,484.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,103.4	2,150.6
Borxhi i jashtëm privat	1,608.6	1,651.7
Borxhi i jashtëm publik	494.8	498.8

Burimi:

1/ ASK (2020).

2/ MF (2020).

3/ BQK (2020).

*Të dhënat për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në shtator 2019.

